

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi:	Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve
Titulli i lëndës:	Historia dhe Stilet në Arkitekturën e Interierit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi - ECTS:	4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Muhamet Ymeri
Detajet kontaktuese:	Muhamet.ymeri@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton njohuritë bazë rreth historikut të arkitektuës në interier si pjesë e stileve arkitektonike në tërësi. Hollësi arkitektonike të interierit dhe dizajnit të mobilieve që përkojnë me periudha të ndryshme historike. Fokusohet kryesisht në parimet bazë të konceptimit dhe dizajnit të mobilieve dhe sot. Stilet e trajtimit të interierit dhe mobilieve, bazuar në stilet më të njohura të arkitekturës. Mobiliet e gjetura dhe përshkrimi i tyre bazuar në relievet e ndryshme. Materialet që janë përdorur për mobilie dhe interierin në përgjithësi dhe që bëjnë dallim në stilin arkitektonik.
Qëllimet e lëndës:	Lënda synon përgatitjen e studentëve me njohuritë e nevojshme rreth historikut arkitektuës në interier. Ka për qëllim kryesor aftësimin lidhur me vlerësimin e stileve të njohura të arkitekturës. Evoluimin e stileve nga ata më të vjetër: Egjiptian, Mesjetar, Perandorak e deri në Modernitet. Vlerësimin e mobilieve sipas trajtimit arkitektonik, hollësive teknike dhe materialeve të përdorura. Njohjen me teknikat e realizimit të mobilieve në periudha të ndryshme të historisë.
	<i>Në përfundim të lëndës studenti duhet të njohë:</i>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Dallimet kryesore të stileve në Interier;</i> • <i>Format dhe detajet që përbëjnë një stil të caktuar dhe artin dekorativ në Interier;</i> • <i>Mobilitet në periudha të ndryshme kohore si pjesë e rëndësishme e interierit;</i> • <i>Të përshkruajë një stil të caktuar, përfshirë aspektet kryesore të identifikimit, teknikat e realizimit, periudhën kohore kur është realizuar;</i> • <i>Si kanë evoluuar stilet arkitektonike në tërësi dhe interieri përgjatë historisë;</i> • <i>Të tregojë kompetencë në trajtimin e stileve më të njohura që ende aplikohen si: Antik, Barok, Gotik, Modern, stilet e linjës së drejtë dhe tendecat e reja.</i>
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit që korrespondon me rezultatet e të nxënies të studentit (duhet të korrespondojë me numrin e krediteve. d.m.th. 1 kredit = 25 orë).

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14	14
Punë praktike	3	1	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	11	11
Ushtrime në teren	3	1	3
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	7	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste studimi</i>
Metoda e vlerësimit:	Punim seminarik (Projekt Kursi) 30% Provimi përfundimtar 70% <i>Provimi mbahet me pyetje të hapura.</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Le Corbusier, Vers une architecture.</i> 2. <i>Lefas Pavlos, Architecture: A Historical Perspective</i> 3. <i>Furniture Dizajn (2015), Jerzki Smardzewcki, Poznan University of Life Sciences, Poland.</i> 4. <i>Bruno Zevi, Historia e arkitekturës moderne, 2012.</i> 5. <i>Understanding Furniture Stiles: Daniele Myers, Dana Ahmed, Lindsay Tomasino, Fenisha Houston, Jose Torres, Jaque Bennet, Basseffiong.</i>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 6. <i>Stuart Lawson: Furniture design, London, 2004 Gëdeshi L, Menaxhimi i prodhimit (2014).</i> 7. <i>Billcliffe R. (2010). Charles Rennie Mackintosh: the complete furniture, furniture drawings & interior designs, New York.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Arkitekturë dhe identitet - Histori
<i>Java e dytë:</i>	Gjetjet më të hershme në Interier (mobiliat)
<i>Java e tretë:</i>	Arkitektura e Interierit dhe dallimet kryesore
<i>Java e katërt:</i>	Arti Dekorativ në Interier
<i>Java e pestë:</i>	Arkitektura egjiptiane e interierit, mobiliat e Egjiptit të lashtë
<i>Java e gjashtë:</i>	Rregullsi dhe mungesë rregullsie: Mesjeta. Mobiliat indiane
<i>Java e shtatë:</i>	Arkitektura greke. Mobiliat e Greqisë së vjetër
<i>Java e tetë:</i>	Arkitektura e Romës së lashtë
<i>Java e nëntë:</i>	Stili Barok dhe Rokoko
<i>Java e dhjetë:</i>	Arkitektura Klasike dhe stili Perandorak
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Periudha e Artit të Ri, Eklektike (mobiliat e zanatlinjve)

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Më pak është më shumë (Less is more) Minimalizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Modernizmi dhe Post-Modernizmi
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Disa veçori të interierit tradicional kombëtar
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Shekulli XXI dhe tendencat
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	